



Kompania e Parqeve
PËR NJË TURIZËM TË QËNDRUESHËM

IDEASS^{ITALI}

Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug - Jug

Prezantim

tekst nga Roberto Di Vincenzo

Territoret e Zonave të Mbrojtura Natyrore italiane përkrijnë përgjithësisht me zonat që, edhe pse historikisht të rëndësishme, kanë sot deficitin më të lartë në zhvillim. Në këto zona, deri në vitet '50, janë bërë përpjekje, jo shumë të suksesshme, për shumë nisma për zhvillimin territorial, të gjitha të karakterizuara nga një program që vinte nga lart dhe nga qëllimi për të risjellë modelin industrial. Duke filluar nga viti 1999, Kompania e Parqeve (Compagnia dei Parchi) ndihmoi në ripropozimin e këtyre zonave të mbrojtura e rurale, duke krijuar një rreth virtuos mes mjedisit, territorit, ekonomisë dhe turizmit. Kompania e Parqeve bën të mundur "kthimin e të ardhurave" për këto territore jo sa duhet të vlerësuar, por të pasur me veçanti, dhe u krijon mundësi popullatave lokale të ringrenë një mikroekonomi në fushën e turizmit, me investime jo të larta fillestare.



Kompania e Parqeve është një shoqëri konsorciumi me përgjegjësi të kufizuar, një shoqëri novatore e pa qëllim fitimi, falë punës së të cilës trashëgimia e patundshme që mund të shfrytëzohet nga turizmi krijon të ardhura, duke luajtur rolin e një *starteri* për një zhvillim të ri ekonomik i cili mbështetet në burimet e vetë territorit. Kompania e Parqeve, nëpërmjet një metode *bottom-up*, rivlerëson cilësitë "e identitetit" të zonave të mbrojtura, trashëgiminë e tyre natyrore, por edhe historike, kulturore, folklorike dhe arkitekturore, duke krijuar një model zhvillimi të qëndrueshëm.

Sistemi operativ i Kompanisë së Parqeve karakterizohet nga një organizim i zhdërvjellët, i cili shtrihet në një seli qendore, që luan rolin e një qendre të vetme prentimesh dhe tregëtimi të ofertave për turistin, dhe një rrjet strukturash pritëse të lidhura mes tyre.

Që nga viti 1999 deri në 2004, Kompania e Parqeve i ka shtrirë veprimtaritë e veta në 16 zona të mbrojtura. Në bashkëpunim me Entet Park përkatëse, ajo ka krijuar një rrjet prej më shumë se 1.000 strukturash pritëse, që promovohen nëpërmjet internetit, panairëve në këtë sektor dhe në rrethet e specializuara për këtë. Përsa i përket cilësisë, Kompania e Parqeve ka ndihmuar përhapjen e kulturës së mikpritjes turistike në zona "tradicionalisht jo të prirura për këtë" dhe ka nxitur zhvillimin e krenarisë së identitetit. Kompania e Parqeve vepron duke e kthyer në fitimprurëse trashëgiminë ekzistuese (shtëpi dhe struktura për pritëse) dhe atë që territori prodhon (produkte tipike, artizanat dhe tregëti e vogël) duke nxitur kështu edhe zhvillimin e veprimtarive të reja të shërbimit turistik. Ky model u jep mundësi subjekteve lokale që, edhe brenda një kohe të shkurtër, të kenë rezultate ekonomike kundrejt investimeve minimale.

Kompania e Parqeve u krijua në vitin 1999 nga shoqëria CARSA (Agjencia e Komunikimit të Integruar, e specializuar në komunikimin turistik dhe atë të mjedisit), në bashkëpunim me Legambiente, Cresme spa dhe me Parqet Kombëtare të Gran Sasso e Monti della Laga, të Macella e Monti Sibillini. Nisma u zhvillua më tej në gjithë territorin dhe po shfaqet interes për ta shtrirë atë në vende të ndryshme të Mesdheut. Në të vërtetë, impostimi i projektit dhe natyra e promotorëve të Kompania e Parqeve-së, shpunë në një bashkëndarje të madhe shoqërore të kësaj nisme, duke bërë kështu të mundur krijimin e një produkti turistik novator, që ndihmon zhvillimin ekonomik në sinergji me fuqizimin e vlerave të identitetit dhe rritjen e krenarisë për përkatësinë ndaj territorit.



Kompania e Parqeve është pika kryesore referuese dhe operative e nismës *Apeninet Park i Evropës*, projekt sistemi për rivlerësimin e Apenineve, nxitur nga Ministria italiane e Mjedisit, nga Legambiente dhe nga Qarku i Abruzzo-s. Modeli operativ Kompania e Parqeve përbën bazën e mocionit *Male të Mesdheut*, miratuar në Bangkok në “Konferencën Botërore për Ruajtjen e natyrës” – IUCN Nëntor 2004.

Cili është problemi që ndihmon të zgjidhe

Kompania e Parqeve e ka nisur punën e saj në vitin 1999, përmes një financimi të Bashkimit Evropian. Lind si një projekt pilot për Zhvillimin Territorial dhe Turizmin e Qëndrueshëm të zonave të mbrojtura të Parkut Kombëtar të Gran Sasso-Monti della Laga, të Parkut Kombëtar të Maiella-s dhe të Parkut Kombëtar të Monti Sibillini.

Kompania e Parqeve punon për të rivlerësuar dhe promovuar zonat park, duke përcaktuar dhe rivlerësuar ndërtesat që mund të ofrojnë pritje për turistët. Që në fillim, Kompania e Parqeve pati rezultate konkrete, duke realizuar në parqet e përfshira një bankë të dhënash në lidhje me banesat si dhe një katalog të ofertës turistike të paorganizuar, ku gjenden 500 banesat e para që mund të merren me qera.

Në vitin 2001 Kompania e Parqeve u shndërrua në një shoqëri konsorciumi me përgjegjësi të kufizuar pa qëllim fitimi (S.C.R.L.), që kish për qëllim të organizonte dhe promovonte mikpritjen në zona të mbrotjura italiane, duke ofruar dhe vënë në



rrjet struktura jo të kovencionuara, si shtëpi mali, ferma, shtëpi stani, shtëpi në qendra historike të fshatrave të vegjël, bed&breakfast, agroturizëm. Kompania e Parqeve e përqëndron promovimin dhe tregëtimin e rrjetit të shtëpive të disponueshme, duke zgjidhur problemin e shpërndarjes së ofertës, që s'mund të përballohet në shkallë lokale.

Institucionet që krijuan Kompaninë e Parqeve dhe që marrin pjesë në veprimtaritë e saj janë:

- **Legambiente.** Shoqata e mjedisit më e shtrirë në Itali me 1.000 grupet e saj lokale, 20 komitete qarku, më shumë se 110.000 anëtarë dhe përkrahës. Legambiente zhvillon një veprimtari ndërgjegjësimi të territoreve në të cilët zbatohet apo mund të zbatohet modeli Kompania e Parqeve.
- **Federparchi.** Federata Italiane e Parqeve dhe e Rezervave Natyrore mbledh rreth vetes 17 parqe natyrore, 69 parqe rajonale, 9 rezerva natyrore tokësore apo detare. E njohur edhe në rang ndërkombëtar, kryen një veprim strategjik për ndërgjegjësimin e veprimtarive të institucioneve dhe enteve të përfshira apo që do të përfshihen më tej.
- **Carsa S.p.A** shoqëri komunikimi për zhvillimin dhe projektimin e mjedisit. Bashkërendon dhe drejton Kompaninë e Parqeve. Ka promovuar idenë, ka zhvilluar modelin organizues dhe strategjinë e marketingut dhe komunikimit.
- **Cresme** shoqëri kërkimore. Ajo ka dhënë metodologjitë për analizat e territoreve, socio-ekonomike dhe të konkurrencës territoriale.
- **Parqet.** Parku Kombëtar Gran Sasso-Monti della Laga, Parku Kombëtar i Macella-s dhe Parku Kombëtar i Monti Sibillini eksperimentuan të parët mënyrat operative të Kompanisë së Parqeve në territoret përkatës.

Sipas kërkimeve të bëra në observatorin turistik të KOMPANIA Ë PARQEVE, Komunitet e parqeve kombëtare italiane shënojnë 118 milionë turistë, për një shumë ekonomike prej 5,5 miliardë euro, me më shumë se 104.000 vende pune të krijuara. Gjithashtu, vetëm dukuria në rritje e ekskursionizmit është një gjendje të sjellë në këto territore 1,4 miliardë shpenzime. Ky treg po rritet dhe Kompania e Parqeve po ndihmon në realizimin e tij, duke përhapur kulturën e mikpritjes së organizuar në rrjet, dhe duke futur në rrjet ofertën jo të organizuar.



Kompania e Parqeve bën të mundur kthimin e trashëgimisë ekzistuese në fitimprurëse (shtëpi e struktura pritjeje) dhe atë çka territori prodhon (produkte tipike, artizanat dhe tregëti e vogël), duke promovuar edhe zhvillimin e veprimtarive të shërbimit turistik. Mënyrat e përfuara u lejojnë aktorëve lokalë që, edhe brenda një kohe të shkurtër, të kenë rezultate ekonomike konkrete me investime dhe ndërhyrje trajnuese minimale. Përgjithësisht ndërhyrjet për zhvillimin e zonave me prirje turistike realizohen përmes investimeve ekzogjene, të cilat ndikojnë negativisht në modelet e kulturës lokale dhe del të kenë pak rezultate për mikroekonominë lokale. Kompania e Parqeve promovon përvojën në nivel “lokal” dhe krijon mundësi rritjeje për sipërmarrjen e territorit.

Projekti i parë i Kompanisë së Parqeve u financua nga Bashkimi Evropian. Më pas, modeli i organizimit të saj u vlerësua pozitivisht nga studime të kësaj fushe dhe kërkime tregu të kryera nga Ente dhe Institute italiane si CENSIS, Enti Kombëtar Italian për Turizmin, CRESME Kërkime.

Qendra kërkimore e Kompanisë së Parqeve u njoh si Observatori Kombëtar i Turizmit në Zonat e Mbrojtura, si pikë referimi për turizmin italian. Së fundi, Modeli i Kompanisë së Parqeve, i cili fillimisht nisi si një eksperiment në tre parqe (Parku Kombëtar Gran Sasso-Monti della Laga dhe Parqet e Macella-s dhe Monti Sibillini) u zbatua më tej në parqe dhe Zona Natyrore të Mbrojtura në 3 Qarqe (Abruzzo, Campania, dhe Umbria) falë nismës *Equal* të Bashkimit Evropian.

Kompania e Parqeve, në praktikë

Ideja për të krijuar Kompaninë e Parqeve lindi nga një analizë mbi mundësitë turistike të zonave të mbrojtura. Nga analizat doli se përballë një oferte që mund të qe cilësore dhe moderne, territoret ofronin produkte jo homogjene e që s'lidheshin mes tyre, pra pa pasur mundësi për t'u futur në ofertat e tureve operatore apo në ofertat turistike të tregut të zgjeruar. Analiza nxirrte në pah se ishte e nevojshme:

- Të shihej mundësia e zhvillimit të një sistemi të integruar të ofertës turistike territoriale, përmes dialogut me komunitetet lokale.
- Të përgatitej një produkt turistik që do të përmbante ofertën e pritjes me të gjithë elementët e sistemit turistik, duke programuar vlera dhe përvoja që janë të afta të bashkojnë kulturën lokale, trashëgiminë natyrore, produktet e tokës, dijet artizanale.
- Të ndërtohej një dimension kombëtar, i aftë të fusë këto produkte në treg, duke ruajtur në nivel lokal hallkën më të rëndësishme të këtij zinxhiri vlerash.
- Të ofroheshin dhe vireshin në rrjet produkte turistike dhe të krahasueshme nga pikëpamja e standartizimit të mënyrave të ofertës.

Nga këto premisa lindi ideja për të krijuar një Tour Operator/Furnizues Shërbimesh i aftë të kapërcejë hendekun tregëtar dhe promociional të sistemit turistik dhe prodhues të zonave të mbrojtura, si përsa i përket ofertës ashtu dhe kërkesës.

Kompania e Parqeve, krijuar përmes financimeve publike, kombëtare dhe atyre të Bashkimit Evropian, u shndërrua në një strukturë të qëndrueshme dhe në rritje. Në Evropë, Kompania e Parqeve përbën një risi përsa u përket funksioneve të promovimit të zhvillimit lokal duke filluar nga organizimi i ofertës turistike, i konceptuar si një sistem i integruar mes turizmit, bujqësisë, artizanatit, shërbimeve pritëse hoteliere dhe jashtëhoteliere.

Kompania e Parqeve është e vetme në llojin e vet pasi karakterizohet nga një strukturë organizuese *bottom-up*, që promovon interesat e gjerë të popullatave që banojnë në zonat e mbrojtura. Luan rolin e një elementi kohezioni mes shtresave të ndryshme të kolektivitetit, duke ndihmuar dialogun mes aktorëve lokalë dhe duke rivlerësuar burimet e tyre turistike, të mjedisit dhe ato arkitekturore.





SISTEMI OPERATIV I KOMPANISË SË PARQEVE

Kompania e Parqeve është një shoqëri konsorcium pa qëllim fitimi. Organizimi i saj mund të ketë forma të shumta financimi:

- Burime publike që vijnë nga nisma kombëtare, lokale apo të jashtme.
- Financime private që vijnë nga veprimtaria e saj e ndërmjetësimit, tregëtimit dhe promovimit të strukturave pritëse (hotele, shtëpi, agroturizëm) që kanë vendosur të hyjnë në rrjetin territorial Kompania e Parqeve dhe që, në mënyrë periodike, japin një kuotë pjesëmarrjeje për të pasur drejtë për shërbimet e saj.
- Financime që vijnë nga projekte të konceptuara, realizuara dhe propozuara nga Kompania e Parqeve.

Kompania e Parqeve, përmes rrjetit të anëtarëve dhe partnerëve të saj institucionalë (Legambiente dhe Federparchi) ballafaqohet herë pas here me Entet Park dhe me Kryetarët përkatës, duke organizuar mbledhje në nivel lokal.


Sistemi operativ i Kompanisë së Parqeve karakterizohet nga një organizim i zhdërvjellët i cili shtrihet në:

- një seli qendrore, që luan rolin e një qendre të vetme prenotimesh dhe tregëtimi të ofertave turistike.
- një numër strukturash pritëse në rrjet mes tyre.

SELIA QENDRORE E KOMPANISË SË PARQEVE

Selia qendrore, herë pas here, lidh kontrata me struktura pritëse të konvencionuara dhe alternativë si hotele, shtëpi, shtëpi mali, shtëpi stani, agroturizme. Në këtë mënyrë selia qendrore lidh marrëveshje për të pasur të drejtën e përparësisë për të prenotuar një apo më shumë dhoma apo dhe gjithë strukturën. Gjithashtu, selia qendrore u ofron strukturave pritëse shërbimin *booking*, të komunikimit dhe promovimit. Me fjalë të tjera, përcakton turistët e mundshëm që duhet të drejtohen tek këto struktura pritëse dhe i promovon ato përmes katalogëve, marrëveshjeve me Tour Operator, nëpërmjet internetit dhe panairëve të sektorit si Bursa Ndërkombëtare e Turizmit. Strukturat pritëse i japin KOMPANISË SË PARQEVE një shpërblim për shërbimet e lëvuara dhe, në disa raste, promovojnë modelin Kompania e Parqeve pranë aktorëve të rinj lokalë.

Functioning of CDP network



Përmes Kompanisë së Parqeve shmangët degradimi i trashëgimisë së patundshme që gjendet në zonën e parkut dhe që zakonisht nuk përdoret, dhe ndihmohet kthimi i të ardhurave për qëllime turistike të gjithë banesave të zonës, e që në përgjithësi janë shtëpi të dyta të pronarëve të tyre.

Kompania e Parqeve kryen pra më shumë se një funksion: promovon turizmin e parqeve; krijon lidhje mes kërkesës dhe ofertës turistike; zhvillon një kulturë të turizmit dhe të mikpritjes të përhapur në territoret italiane më pak të zhvilluara, që shpesh përkohet me zonat park, duke ndihmuar kështu lindjen e sipërmarrjes turistike, edhe përmes ndërhyrjeve që synojnë formimin.

Struktura e selisë qendrore të bashkërendimit, tregëtimit, marketingut dhe formimit

- **Zyra e bashkërendimit dhe projektimit:** përbehet nga personel i ngarkuar me përcaktimin apo fuqizimin e marrëdhënieve me zonat e mbrojtura dhe me të gjithë ata që kanë struktura të cilat mund të ofrojnë mikpritje të turistëve. Zyra ka për detyrë edhe të përpunojë projekte që mund të financohen nga nisma kombëtare dhe ndërkombëtare, apo nga subjekte private të interesuar të zbatojnë modelin Kompania e Parqeve në territore specifike.
- **Zyra tregtare:** përbehet nga personel i ngarkuar të kontraktojë marrëdhëniet me strukturat pritëse dhe të dialogojë me Tour Operator, Agjenci Udhëtimesh dhe aktorë të tjerë të interesuar të prenotojnë pushime e qëndrime në zonën park.
- **Zyra e marketingut:** e përbërë nga personel i ngarkuar me përpunimin e strategjisë së marketingut dhe komunikimit për të rritur vizionin e Kompania e Parqeve-së në tregun turistik.
- **Zyra e formimit:** e përbërë nga personel i ngarkuar me përpunimin e mënyrave e përgatitjes së kurse të formimit për tema që lidhen me marketingun turistik, legjislacionin komunitar dhe kombëtar për turizmin, modelin organizues të Kompania e Parqeve-së.

Rrjeti i përhapur në territor për organizimin e ofertës turistike

Nga pikëpamja e organizimit, Kompania e Parqeve vepron me një rrjet territorial i cili organizon, promovon dhe menaxhon mikpritjen në ndërtesa e struktura pritëse të lidhura mes tyre. Rrjeti territorial është në të vërtetë përgjigjia më efektive ndaj copëzimit dhe të qenit jo homogjen të ofertës dhe ndaj vështirësisë që çdo operator turistik më vete ka për t'u bërë i njohur. Organizimi në rrjet bën të mundur zhvillimin e një oferte të gjerë, e aftë të bëhet pjesë e një game të larmishme kërkesash (për nga lokaliteti, tipologia, hapësira e çmimeve) dhe pra për t'u drejtuar një rrezeje gjithnjë e më të madhe klientësh të mundshëm, duke ofruar një përgjigje që përkon me kërkesën turistike cilësore.

Rrjeti në territor për menaxhimin e strukturave dhe shërbimeve për turistin përbëhet nga:

- **Welcome Point:** pret turistin në kohën që ai mbërrin në vendin e pushimit (Anëtarësim i nivelit 1°). Është fjala për shoqëri, ndërmarrje individuale, kooperativa lokale të lidhura në rrjet Intranet me centralin operativ të Kompanisë së Parqeve. Menaxhon prenotimet territoriale dhe ia beson turistin House Keeper, që në disa raste mund të përkohet edhe me atë që menaxhon Welcome Point.
- **House Keeper:** ka çelësat e banesës dhe ia dorëzon ato turistit. *House keeper*-at janë menaxherë të strukturave turistike pritëse, apo "administratorë" të një apo më shumë godinave apo të një "bashkëpronësie të gjerë", në bazë të një kontrate që është lidhur me pronarin.
- **Dealer apo ndërmjetësues** zhvillon dhe bashkërendon rrjetin e House Keeper dhe të Welcome Point të zonës që kanë në kompetencë (Anëtarësim i nivelit të 2°). Dealer-at mund të jenë edhe menaxherë të Welcome Point dhe House Keeper.





Modeli operativ në Parkun Kombëtar të Gran Sasso e Monti della Laga

Parku Kombëtar i Gran Sasso e Monti della Laga shtrihet në territorin e Qarkut të Abruzzo-s dhe, pjesërisht, të Qarqeve Marche e Lazio. Në Abruzzo zona e parkut përfshin 40 Komuna që u përkasin Provincave të Aquila-s, Teramo-s dhe Pescara-s dhe 5 Komunitete Malore. Situata socio-ekonomike karakterizohet nga:

- Një vartësi e madhe e ekonomive lokale nga transferimi i të ardhurave nga jashtë, përmes pensioneve, banorëve të tyre që punojnë jashtë zonës duke bërë vajtje-ardhje çdo ditë, flukset e shpenzimit që lidhen me turizmin sezonal.

- Një nivel i ulët i treguesit në lidhje me larminë e veprimtarive prodhuese, që përbën padyshim një pikë të dobët të strukturës së ekonomisë lokale, dhe që e ekspozon ndaj të ashtuëquajturit rrezik të sektorit.
- Rritje shumë e ulët e banorëve në krahasim me pjesën tjetër të Qarkut të Abruzzo-s

Kompania e Parqeve ka krijuar një Learning Center, që luan rolin e një pike kyçe dhe të një “katalizatori” për krijimin e një rrjeti të qendrave periferike të informacionit, dhe pikë referimi për rrjetin e aktorëve territorialë. Projekti ka realizuar këto veprimtari:

- Është krijuar një rrjet me 3 Qendra Informacioni Turistik territorial (CIT-QIT), që janë qendra formimi dhe informacioni në territorin abrucez të Parkut, i cili lidhet me Learning Center.
- Pranë Learning Center janë realizuar trajnime për operatorët e informacionit dhe të orientimit, tutorët, formatorët, koordinatorët e Qendrës dhe të zyrave periferike. CIT-et kanë krijuar disa module trajnimi në distancë të përgatitur nga Kompania e Parqeve dhe nga Learning Center, për t’i futur në rrjetin e Kompanisë së Parqeve. Çdo CIT ka strukturat e veta operative dhe është i lidhur me Learning Center me internet (msn messenger). Strukturat operative të rrjetit, përveç pajisjeve informatike, ofrojnë shërbime trajnimi, informacioni turistik dhe janë mjetet operative të Kopanisë së Parqeve, të cilat luajnë rolin e ndërmjetësve për gjithë ofertën turistike lokale reale (struktura pritëse ekzistuese) dhe të mundshme (shtëpi që mund të përdoren për të pritur turistët).
- Janë zhvilluar veprimtari për përfshirjen aktive, me informacion të përqëndruar, pjesëmarrje në panairë dhe ekspozita në nivel lokal.

Learning Center punëson 2 profesionistë për formimin dhe këshillimin orientues. CIT-et punësojnë 3 operatorë, të përzgjedhur dhe të kualifikuar, të cilët kanë marrëdhënie të vazhdueshme me partnerin dhe përgjegjësin e Learning Center për orientimin e zgjedhjeve dhe programimit të veprimtarive. Puna, që përfshin më shumë se 30 profesione, ka të bëjë sidomos me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e drejtpërdrejtë të vendeve të fjetjes, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve dhe rrugëve të intinerarit në territor, guidat e specializuara, kooperativat që organizojnë ekskursione dhe transferime, veprimtari propagandimi dhe komunikimi.

Rezultatet

Modeli novator operativ i Kompanisë së Parqeve ka patur rezultate shumë rëndësishme:

- Ka nxitur ruajtjen e vlerave të identitetit të zonave park në trevat italiane, duke ndihmuar rilindjen e krenarisë së përkatësisë ndaj pupullatave që kanë mbetur ekonomikisht të dobëta dhe të marginalizuara nga pikëpamja shoqërore.
- Ka ofruar modele të reja operative e funksionale për Entet Park, me qëllim që ato të shndërrohen në “inkubatorë” të zhvillimit të zonave të mbrojtura dhe jo thjesht në aktorë të mbrojtjes.

- Ka krijuar një zhvillim ekonomik lokal, duke i rikthyer të ardhurat një trashëgimie të patundshme tashmë në rënie a shkatërrim.
- I ka dhënë dinjitet produktit turistik të zonave park. Në se sot turizmi në Parqe është bërë një realitet i fuqishëm dhe i pandarë nga sistemi i ofertave të markës ‘Itali’, kjo gjë i detyrohet edhe Kompanisë së Parqeve.

Kompania e Parqeve ka promovuar dhe organizuar ofertën turistike kombëtare dhe në 16 zona të mbrojtura:

- Parku Kombëtar Gran Sasso e Monti della Laga — Qarqet Abruco e Marke
- Parku Kombëtar Abruzzo, Lazio e Molise — Qarqet Abruco, Lacio e Molize
- Parku Rajonal Monte Cucco — Qarku i Umbria-s
- Parku Kombëtar Monti Sibillini — Qarqet Marke dhe Umbria
- Parku Rajonal Sirente Velino — Qarku i Abruco-s
- Parku Kombëtar Macella — Qarku i Abruco-s
- Rezervati Natyror Rajonal Zompo lo Schioppo — Qarku i Abruco-s
- Rezervati Natyror i Monte Genzana Alto Gizio — Qarku i Abruco-s
- Parku Kombëtar i Gargano-s — Qarku i Pulje-s
- Parku Kombëtar i Cinque Terre — Qarku i Liguria-s
- Parku Kombëtar i Dolomiti Bellunesi — Qarku i Veneto-s
- Parku Kombëtar i Foreste Casentinesi, Monte Falterona e Campigna — Qarqet Emilia Romanja e Toskana
- Parku Kombëtar i Pollino-s — Qarqet e Bazilikatës dhe Kalabrisë
- Parku Kombëtar i Vezuvit — Qarku i Kampania-s
- Parku Kombëtar Cilento e Vallo di Diano — Qarku i Kampania-s
- Parku Rajonal Delta del Po — Qarku i Emilia-Romanjës

Rezultatet e ndikimit të Kompanisë së Parqeve, duken më mirë në përshkrimin e rezultateve të arritura në Parkun Kombëtar të Cilento e Vallo di Diano.

REZULTATET NË PARKUN KOMBËTAR TË CILENTO E VALLO DI DIANO



Parku Kombëtar i Cilento e Vallo di Diano gjendet në Qarkun e Kampania-s dhe përfshin territorin prej 80 Komunash të Provincës së Salernos. Situata socio-ekonomike karakterizohet nga:

- Një vartësi e madhe që ekonomitë lokale kanë ndaj ardhjes së të ardhurave nga jashtë, përmes pensioneve, punësimet në zonat përreth, dërgesave nga emigrantët, flukset e shpenzimit që lidhen me turizmin sezonal.
- Një nivel i ulët i treguesit në lidhje me larminë e veprimtarive prodhuese, që përbën padyshim një element dobësie strukturore për ekonominë lokale, dhe që e ekspozon atë ndaj të ashtuquajturit rrezik të sektorit.
- Rritje shumë e ulët e banorëve ndaj pjesës tjetër të Qarkut të Kampania-s, sidomos në zonat malore dhe në trevat e brendshme të parkut.
- Një dallim që konsiston mes komunave më të zhvilluara bregdetare të parkut dhe atyre malore.
- Një përqindje analfabetismi prej 6,9% (në disa komuna në brendësi kuota e kalon 10%).
- Një numër personash pa titull studimi, që përkon me 19,2% kundrejt 15,8% të provincave.
- Një numër personash që kanë mbaruar shkollën e mesme, e që përkon me 13,3% kundrejt 16,2% të provincës.

Në dhjetëvjeçarin e fundit, territori ka shënuar një përmirësim në lëvizjen turistike që kap shifrën 6%, por kjo rritje ka të bëjë sidomos me bregdetin e zonës salentin, që ka aftësi të mëdha tërheqëse si për të huajt ashtu dhe për vetë italianët. Për t'u ofruar edhe zonave më të largëta e më pak të zhvilluara një mundësi për t'u zhvilluar ish e nevojshme të mendoheshin politika për ndërhyrje të mirëpërcaktuara, me nisma të integruara e të afta të ofrojnë paketa që u përqasin bukurive natyrore të detit edhe kulturën, sportin dhe kuzhinën. Zona kodrinore dhe malore e Parkut, përpara ndërhyrjes së Kompania e Parqeve-së ishte shumë pak e interesuar ndaj dukurisë së turizmit. Gjithashtu, bregdeti, përmes rritjes spontane të ofertave të hotelarisë në përmasa të vogla dhe cilësi jo shumë të lartë dhe të qeramarrjes private të godinave, rezultonte të prekej rëndë nga një zhvillim urbanistik i një cilësie shumë të keqe.

Kompania e Parqeve ka krijuar një Learning Center (Qendra e formimit dhe të nxënimit) që luan rolin e një nyjeje qendrore dhe të një "katalizatori" për krijimin e një rrjeti të Qendrave Periferike të Informacionit, por dhe pika referimi për rrjetin e aktorëve territorialë. Projekti është zhvilluar përmes:

- Krijimit një rrjeti me 8 Qendra të Informacionit Turistik CIT, zyra trajnimi, informimi dhe këshillimi, të shpërndara në territorin e Parkut, e që kanë lidhje me Learning Center. Struktura ka lëvruar shërbime për të orientuar menaxhimin e Parkut drejt zgjedhjeve të administrimit që janë në gjendje të ndryshojnë ekonomitë ekzistuese drejt politikave më tipike të ekonomive të mirëformuara.
- Veprimtari trajnimi, pranë Learning Center, për operatorë të informacionit dhe orientimit, tutorë, formatorë, koordinatorë të Qendrës dhe të zyrave periferike, duke krijuar kushtet për funksionimin e rrjetit të CIT.
- Veprime të përfshirjes aktive, me informacion të mirëpërcaktuar, pjesëmarrje në panairë dhe ekspozita lokale, hapje tryezash dialogu e debati, reale dhe virtuale.



Pranë 8 Qendrave të Informacionit Turistik janë realizuar 8 kurse trajnimi në distancë, të përgatitur nga Kompania e Parqeve dhe nga Learning Center. Më pas, 8 CIT janë futur në rrjetin e Kompanisë së Parqeve. Çdo CIT është i pajisur me struktura operative dhe është i lidhur me Learning Center me internet (msn messenger). Strukturat operative të rrjetit, përveç pajisjeve informatike, ofrojnë shërbime formimi dhe informacioni turistik. Janë mjetet operative të Kompania e Parqeve-së që luajnë rolin e ndërmjetësve me tërësinë e ofertës turistike lokale reale (struktura pritëse ekzistuese) dhe të mundshme (shtëpi që mund të ofrojnë pritje për turistët).

REZULTATET E ARRITURA NË ZONËN PARK Learning Center punëson 2 profesionistë për formimin dhe këshillimin orientues. Këta operatorë zhvillojnë kompetenca e njohuri profesionale dhe mjete operative për t'u dhënë udhë nismave të promovimit të trashëgimisë (së ndërtimit, turizmit, mjedisit) si brenda ashtu dhe jashtë territorit të qarkut, sa më gjerë e duke u organizuar në rrjet. CIT-et punësojnë 16 operatorë, të përzgjedhur dhe të kualifikuar, të cilët, për të orientuar zgjedhjet dhe programimin e veprimtarive, kanë marrëdhënie të vazhdueshme me partnerin dhe përgjegjësën e Learning Center. Kjo veprimtari, që përfshin më shumë se 30 profesione, ka të bëjë sidomos me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e drejtpërdrejtë të vendeve të fjetjes, me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve dhe rrugëve të intinerarit në territor, guidat e specializuara, kooperativat që organizojnë ekskursione dhe udhëtime, veprimtari propagandimi dhe komunikimi. Në përgjithësi, punësimi i drejtpërdrejtë dhe puna e Kompanisë së Parqeve në Parkun Kombëtar të Cilento-s e Vallo di Diano përfshin rreth 48 zyra.



Rrjeti Kompania e Parqeve ka rritur disponibilitetin në 480 vende fjetjeje, dhe 20 oferta për fundjavë dhe javore, duke përfshirë Administrat lokale, aktorët socialë, pronarët e shtëpive dhe strukturave pritëse të interesuara. Kompania e Parqeve i ka dhënë udhë një perspektive të zhvillimit të vetëpërqëndruar, në përputhje me prirjet e territorit, me veprime të marketingut dhe vetësipërmarrjes. Kjo punë ka rivlerësuar trashëgimitë kulturore dhe të mjedisit që më parë nuk njiheshin si të tilla, dhe gjithashtu ka rivlerësuar trashëgimitë e identitetit që lidhen me traditat, enogastronominë, artizanatin cilësor. Rrjedhoja më e rëndësishme e këtyra nismave, qëndron në të vërtetë në rizbulimin e vlerave, duke i dhënë kredibilitet e duke njohur identitetin e humbur që bën të ngjallet tek banorët e këtyre zonave krenaria e përkatësisë dhe fuqizimi i lidhjes me vendet: vlerat themelore për të besuar në një tjetër mundësi rritjeje të vetëpërqëndruar, duke larguar fantazmën e tmerrshme të emigracionit.

Megjithatë, këto rezultate, do mund të llogariten në shifra vetëm pas një kohe të konsiderueshme të zhvillimit të veprimtarive të Kompanisë së Parqeve.

Interesi ndërkombëtar

Modeli operativ i Kompanisë së Parqeve u njoh nga Bashkimi Evropian i cili financoi projektin e parë pilot (programet Adapt II dhe Agrus). Projekti bëri të mundur eksperimentimin e modelit në Parqet Gran Sasso – Monti della Laga, Macella dhe Monti Sibillini. Suksesi dhe rezultatet konkrete të arrira, krijuan kushtet e besimit për financime të tjera të Bashkimit Evropian (programmi Equal) që krijuan mundësinë për zgjerimin e nismave të Kompanisë së Parqeve në Qarqet e Umbria-s dhe Kampania-s.

Federata Italiane e Parqeve, e nxitur nga suksesi i arritur në vend dhe në veçanti në Parkun Kombëtar të Gran Sasso e Monti della Laga, mbështeti ndryshimin e Kompanisë së Parqeve në një Shoqëri *pa qëllim përfitimi*, që duhet të luajë rolin e një Tour Operator-i dhe të një shoqërie shërbimesh për zhvillimin e qëndrueshëm të Parqeve Italiane.

Qeveria Shqiptare ka përfunduar modelin operativ të Kompanisë së Parqeve si një pikë referimi për promovimin e zonave të mbrojtura të vendit. Qeveria shqiptare ka shprehur zyrtarisht interes duke iu bashkuar kërkesës për një financim për nismën Life Third Country të Bashkimit Evropian.

Kompania e Parqeve përfaqëson pikën e referimit për zhvillimin turistik të *A.P.E. Apenini Park i Evropës*, Projekt sistemi i promovuar nga Ministria e Mjedisit dhe nga Legambiente. Nisma më pas u shëndërrua në Projekt të sistemit të *Male të mesdheut*.

Kompania e Parqeve u paraqit si palë e Projektit të sistemit *Male të Mesdheut* në Kongresin e Tretë Botëror për Ruajtjen e Natyrës, mbajtur në Bangkok në vjeshtën e vitit 2004 dhe organizuar nga Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës UICN, organizëm ndërkombëtar ku bëjnë pjesë 140 vende, 77 shtete, 114 agjenci qeveritare, më shumë se 800 organizata jo qeveritare dhe më shumë se 10.000 shkencëtarë dhe ekspertë me famë ndërkombëtare për të punuar sëbashku në mbrojtje të mjedisit.

Modeli operativ i Kompanisë së Parqeve u paraqit gjithashtu në Spanjë, gjatë 1st International Conference on Responsible Tourism Management in Unique Coastal Destinations, organizuar nga Komuna e Sitges.

Kompania e Parqeve merr pjesë në fazën e dytë të Programit të Bashkimit Evropian Equal, kushtuar përhapjes dhe mainstreaming. Nisma parashikon pikërisht përhapjen e rezultateve të arritura nga Kompania e Parqeve në Itali dhe në Evropë në mënyrë që modeli Kompania e Parqeve të mund të gjejë jehonë e të pranohet në vendet e tjera të interesuara.



Për të realizuar Kompaninë e Parqeve në vende të tjera

Për të krijuar modelin operativ të Kompanisë së Parqeve në vende të tjera, është e domosdoshme të krijohet një rrjet marrëdhëniesh me të gjitha ato institucione publike që, në mënyrë të drejtpërdrejtë e të tërthortë, kanë për detyrë të promovojnë territoret me rëndësi të madhe turistiko-mjedisore dhe që nuk janë rivlerësuar siç duhet.

Kushtet bazë për të përsëritur modelin operativ në vende të tjera janë:

- Një kuadër rregullimesh ligjore kombëtare që duhet të garantojë rregullat e tregut e pranuar nga të gjithë, si dhe krijimin e një sistemi të ofertës turistike lokale.
- Hyrjen në konventat ndërkombëtare të cilat rregullojnë tregun turistik nga ana e vendit që synon të eksperimentojë novacionin.
- Një kuadër ligjor që ndihmon krijimin e një sipërmarrjeje të vogël e të përhapur, duke ulur detyrimet formale dhe burokratike.

- Motivimi i një komuniteti lokal të organizuar që udhëheq territorin.
- Prania e institucioneve që luajnë rolin e menaxhuesve të territorit (Ente park, Administratat vendore dhe komunitetet) dhe organizatat jo qeveritare që janë të afta të jenë shumë të pranishme në territor.

Nga pikëpamja kulturore, është shumë e rëndësishme që komunitetet të banojnë në territoret e përfshira në zbatimin e modelit Kompania e Parqeve, të kenë këto karakteristika:

- të jenë të vetëdijshme për burimet e tyre dhe të potencialitetit turistik që ato shprehin
- të jenë të gatshme të përftojnë e të mirëpresin nga jashtë propozime për zhvillimin lokal
- të jenë të prirura, nga pikëpamja kulturore, ndaj punës në grup dhe ndaj lidhjeve me bashkëbisedues të ndryshëm: subjekte institucionale, palë ekonomike e sociale, komunitete, shoqata kategorie.



Kushte të tjera të territorit të cilat janë të domosdoshme për përftimin e modelit operativ të Kompanisë së Parqeve janë:

- ekzistenca e një trashëgimie të patundshme (hotele, shtëpi, kasolle dhe tipologji të tjera) që mund të ofrojnë sistemim për turizmin.
- Akses i mundshëm në territor

Të gjitha institucionet italiane të përfshira në menaxhimin e Kompanisë së Parqeve, Parku Kombëtar Gran Sasso, Legambiente, Carsa s.p.a., Federparchi dhe Cresme, janë të gatshëm t'u japin asistencë teknike vendeve të interesuara për aspekte të ndryshme të vënies në jetë të këtij sistemi.

Për të ditur më shumë

Institucionet dhe personat që kanë dokumentacion mbi Kompaninë e Parqeve janë:

Roberto Di Vincenzo,
President i KD të CARSA S.P.A.
Edizioni&Comunicazione Integrata
Tel. ++39 085 43031
Fax ++39 085 4303250
++39 085 4303613
www.carsa.it
info@carsa.it
roberto.divincenzo@carsa.it

Fabio Renzi,
Sekretaria Kombëtare LEGAMBIENTE
Selia Kombëtare: Via Salaria n. 403 - 00199 Roma
Tel. ++39 06 862681
parchi@mail.legambiente.com
www.legambiente.com

COMPAGNIA DEI PARCHI S.C.R.L.
Selia Ligjore: via dei Cimbri n. 23
80138 Napoli/Italy
Selia Operative: via Salara Vecchia 1
65128 Pescara/Italy
Tel. ++39 085 4316321
++39 085 4310440
Fax ++39 085 4303250
++39 085 4303613
www.compagniadeparchi.com
info@compagniadeparchi.com

Amilcare Troiano, Zëvendës President
FEDERPARCHI
Via Cristoforo Colombo 149 - 00199 Roma
Tel ++39 06 51604940
Fax ++39 06 51430472
www.parks.it
segreteria.federparchi@parks.it

Walter Mazzitti,
President i Parkut Kombëtar
Gran Sasso Monti della Laga
Selia: Tel. ++39 0862 60521
ente@gransassolagapark.it
www.gransassolaga.it

Sandro Polci,
Këshilltar i Deleguar SERICO
Gruppo CRESME Ricerche (S.P.A.)
Via Fogliano, 15 - 00199 Roma
Tel. ++39 06 8848403

Kë duhet të kontaktoni

Për të krijuar bashkëpunim, kontaktoni:

Roberto Di Vincenzo: President Carsa Spa, Administrator i deleguar i Kompania e Parqeve

COMPAGNIA DEI PARCHI S.C.R.L.

Selia Ligjore: via dei Cimbri n. 23 - 80138 Napoli/ Italy
Selia Operative: via Salara Vecchia 1 - 65128 Pescara /Italy
Tel. ++39 085 4316321 / ++39 085 4310440
Fax ++39 085 4303250 / ++39 085 4303613

CARSA S.p.A. Edizioni&Comunicazione Integrata

Tel. ++39 085 43031
Fax ++39 085 4303250 / ++39 085 4303613
roberto.divincenzo@carsa.it



CARSA spa
Edizioni &
Comunicazione Integrata 

iniciativa IDEASS – Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug – Jug është promovuar nga programet e mëposhtme për bashkëpunim ndërkombëtar: ILO/Universitas, UNDP/APPI, dhe UNDP/IFAD/UNOPS Programet për Zhvillim Njerëzor dhe Programet Kundër Varfërisë, aktualisht prezente në Shqipëri, Angola, Kolumbi, Kubë, El-Salvador, Guatemalë, Honduras, Mozambik, Nikaragua, Republikën Domenikane, Serbi, Afrikën e Jugut e Tunizi. Iniciativa e bashkëpunimit është rezultat i Samiteve Botërore në vitet 1990 dhe i Asamblesë e Përgjithshme të Mileniumit; ajo i jep përparësi bashkëpunimit mes protagonistëve në Jug, me mbështetjen e vendeve të industrializuara.

Qëllimi i IDEASS është të forcojë efektivitetin e proceseve të zhvillimeve lokale përmes përdorimit në rritje të inovacioneve për zhvillim njerëzor dhe kushte të mira pune. Përmes projekteve të bashkëpunimit jug-jug, ata veprojnë si një katalizator për përhapjen e inovacioneve sociale, ekonomike dhe teknologjike që favorizojnë zhvillimin ekonomik dhe social në nivel lokal. Inovacionet e promovuara mund të jenë produkte, teknologji, ose praktika sociale, ekonomike, ose kulturore. Për më tepër informacion rreth Iniciativës IDEASS vizitoni faqen e internetit: www.ideassonline.org

IDEASS

Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug - Jug



Programi i PNUD-it Iniciativat e Partneritetit Kundër – Varfërisë (APPI) është një program i projektuar për të ndihmuar qeveritë dhe aktorët socialë për të vendosur dhe zbatuar politika kombëtare për uljen e varfërisë dhe përfshimit social, bazuar në praktikën e zhvillimit të integruar dhe gjithëpjesëmarrës në nivel lokal.



Programet për zhvillim njerëzor dhe kundër varfërisë të zbatuara UNDP, IFAD, ILO, dhe UNOPS përkrahin proceset e zhvillimit lokal të integruar dhe gjithëpjesëmarrës brenda kornizës së politikave kombëtare, me mbështetjen e aktoreve publike, private, dhe shoqërisë civile. Këto programe sigurojnë kornizën brenda së cilës vendet dhuruese dhe komunitetet në vendet e industrializuara mund të bashkëpunojnë në mënyrë të organizuar, përmes bashkëpunimit të decentralizuar. Brenda kësaj kornize do të realizohen dhe bashkëpunimet jug – jug përmes Iniciativës.



Programi ILO/Universitas (punë korrekte përmes trajnimit dhe inovacionit) inkurajon përdorimin e zgjidhjeve inovative të problemeve në zhvillimin njerëzor, veçanërisht në botën e punës. Për të arritur këtë, ai kryen veprimtari kërkimore dhe trajnon vendim-marrësit dhe personelin që punon për zhvillimin lokal.



Në Shqipëri, IDEASS është një iniciativë e programit PASARP (Programi i Aktiviteteve në Mbështetje të Qarqeve dhe Prefekturave Shqiptare), realizuar nga IFAD/UNOPS me fondet e bashkëpunimit italian.